

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K



Sot, më datë 09/07/2007, ne te nënshkruarit:

- Shoqëria "BEG" spa person juridik Italian, e regjistruar ne dhomen r tregetise,industrise, artizanatit dhe bujqesise te Romes, me numer regjistri 7165/95, e perfaqesuar nga z. Sante Diotallevi.
- Shoqëria "Energji" shpk, person juridik shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit gjyqesor Tirane me nr. regjistri 30688 me date 18.12.2003, i perfaqesuar nga Z.Andi Kondi.
- Shoqëria "CO.LA.RI" Konsorciumi i Lacios per mbeturinat, e regjistruar ne dhomen e tregetise,indutrise,artizanatit dhe bujqesise se Romes me nr.regjistri 06725630583/96 e perfaqesuar nga z.Aldo Ceccobelli.

në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 14.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është **"KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K**

Neni 2

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Nr. 2, Ap.30, Tirane, Shqipëri. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashte territorit te vendit.

Neni 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pakufizuar, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 4

Qellimi I aktivitetit te shoqerise eshte I lidhur ne menyre te drejtperdrejte me objektin e mireposhtem:

- a) Projektimin,zhvillimin, organizimin,permbushjen, menaxhimin dhe mirembajtjen e impiantit hidroelektrik me nje fuqi rreth 100MW qe do te

ndertohet ne Shqiperi ,ne Kalivac ,ne zonen e Krahesit,provinces se Tepelenes te rrethit Gjirokaster.(qe ketu e meposhte do te quhet "Impianti hidroelektrik"). Perdorimi ne menyre te terthorte I nje koncesioni me afat 30 vjecar te impiantit hidroelektrik dhe qe rregullohet me ane te ligjit shqipetar te 26 korrikut 1995 nr.7973 me ndryshimet e metejshme.

- b) Shitjen ne territorin shqipetar si dhe eksportimin e energjise elektrike te prodhuar nga impianti hidroelektrik si dhe ne emer te paleve te treat.
- c) Realizimi i aktivitetit kerkimor ,konsulences dhe mbeshtetjes ne te gjitha fushat te lidhura me qellimin e aktivitetit dhe cdo aktivitet tjeter qe do te lejonte perdorimin dhe vleresimin e strukturave,resurseve dhe aftesive qe jane te perfshira dhe ne ndonje menyre te lidhura apo te rendesishme per impiantin hidro elektrik dhe per projektin e zhvillimit te tij; dhe
- d) Realizimi e atij aktiviteti te lidhur,instrumental apo te ngjashem a komplementar dhe ne ndonje menyre te dobishem per permbushjen e sherbimeve dhe /ose te aktiviteve te siperpermendura.

Shoqeria do te jete e afte permbushe qellimin e aktivitetit te saj primar dhe aktivitetit te saj sekondar brenda kufijve te parashikuar nga ligji i aplikueshem,me perjashtim te gjitha aktiviteve te rezervuara te parashikuara me ane te dispozitave te vecanta, te lidhura kryesisht me sektoret e sherbimeve profesionale financiare dhe bankare si dhe:

- I. Te permbushe te gjitha transaksionet tregetare,industriale,te lidhura me pasurite e paluajtshme,kembimit valutor dhe finciar ,te nevojshem qofte edhe vetem per qellimin e aktivitetit.
- II. Te akordoje mbeshtetje dhe garanci ,te vendose hipoteke mbi asetet e paluajtshme te shoqerise si dhe cdo lloj garancie tjeter qofte edhe garanci reale ne lidhje me detyrimet e saj apo te paleve te treta ;dhe
- III. Te perfitojne ne menyre direkte apo indirekte ,interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqipetare apo te huaja qe kane nje qellim te njejte biznesi ,te lidhur me qellimin e vete shoqerise ,apo te shoqerive te tjera dhe ne funksion te nje investimi permanent pervec aktiviteve qe lidhen me kryerjen e kembimit valuator dhe qe nuk kryhen kundrejt publikut.

Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 500,000 leke i perbere nga 500 pjese me vlere nominale 1000 leke secila .

Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- Shoqeria BEG S.p.A, zoteron 70% te kapitalit fillestar te shoqerise me vlere 350,000 (treqind e pesedhete mije)Leke.

- Shoqëria "Energji" shpk, zoteron 20% të kapitalit fillestar të shoqërise me vlerë 100,000 (njëqind mijë) Leke.
- Shoqëria CO.LA.RI, zoteron 10% të kapitalit fillestar të shoqërise me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) Leke.

Neni 6

Shoqëria është e organizuar në formën e mëposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve.
- 2- Keshilli Administrativ.

Administratore të shoqërise janë si më poshte:

1. Z.Francesco Becchetti, shtetas italian, lindur në Rome - Itali me 31.08.1966, banues në Rome - Itali, via indonesia 70, mbajtes i pasaportes me nr. B 841745 kryetar i keshillit administrativ.
2. znj. Liliana Condomitti, shtetase italiane, lindur në Rome - Itali me datë 2.09.1941, banuese në Rome - Itali, via indonesia 70, mbajtese e pasaportes me nr. AA0405895.
3. Z.Andi Kondi, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, shqiperi me 27.05.1971, banues në Tiranë, rr. "Mihal Grameno" pallati 94, shk.2 ap 25.

Ortakët mund të vendosin lejimin e një shpërblimi në favor të Administratoreve për kryerjen e detyrës përveç pagimit të shpenzimeve.

Kompetencat e Asamblese së Ortakeve si dhe të administratoreve të shoqërise janë të parashikuara në statutin e shoqërise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretet e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë percaktuar si të tilla nga administratoret e shoqërise.

Neni 8

Mardheniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjisllacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsiper të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për demet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 9

Në rast se shoqëria do të vendoset të likujdohet, atëherë do të emërohet një komision për likuidimin i cili do të paraqesë për miratim raportin e likuidimit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një ekspertit ose revizori kontabel. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për atë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Ortaket caktojnë dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

Neni 11


Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratoret marrin masat me qëllim hartimin e bilancëve, rezultateve ekonomike të fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit të ceshtjeve të mesipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, të ardhurat e tjera do të ndahen ortakut të shoqërisë.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe atë angleze, Ortaket e shoqërisë autorizojnë Avokatin Evelina Qirjako, sikurse dhe çdo vokat të zyrës së saj, të ndjeke të gjitha procedurat për regjistrimin e shoqërisë në zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKET E SHOQËRISË "KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K


Shoqëria Beg spa
Perfaqësuar nga Sante Diotallevi



Shoqëria "GO.LA.RI" srl
Perfaqësuar nga Aldo Ceccobelli



Shoqëria "Energji" shpk
Perfaqësuar nga Andi Kondi.



STATUTI I SHOQERISE

"KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K



Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare", dhe ligjit 7667 date 28.1.1993 "Per Regjistrin Tregtar", ne te nenshkuarit shpallim si me poshte vijon:

THEMELIMI I SHOQERISE

Neni 1

Formohet shoqeria e quajtur **"KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K**, I cili ketu e me poshte do te quhet si shoqeria.

Ortaket e shoqerise jane si me poshte:

- Shoqeria "BEG" spa person juridik Italian, e regjistruar ne dhomen r tregetise, industrise, artizanatit dhe bujqesise te Romes, me numer regjistri 7165/95.
- Shoqeria "Energji" shpk, person juridik shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit gjyqesor Tirane me nr. regjistri 30688 me date 18.12.2003.
- Shoqeria "CO.LA.RI" Konsorciumi i Lacios per mbeturinat, e regjistruar ne dhomen e tregetise, industrise, artizanatit dhe bujqesise se Romes me nr. regjistri 06725630583/96.

SELIA ZYRTARE

NENI 2

Selia zyrtare e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit", Nr. 2, Ap.30, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te themeloje gjate aktivitetit te saj dege apo filiale brenda apo jashte territorit te Shqiperise.

KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE EKONOMIKE

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete 50 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe mund te zgjatet me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Neni 4

Qellimi I veprimtarise I vete shoqerise apo I kryer nepermjet degeve te saj eshte si me poshte .

- a) Projektimi, zhvillimi, organizimi, permbushja, menaxhimi dhe mirembajtjen e impiantit hidroelektrik me nje fuqi rreth 100MW qe do te ndertohet ne Shqiperi ,ne Kalivac ,ne zonen e Krahesit,provinces se Tepelenes te rrethit Gjirokaster. (qe ketu e meposhte do te quhet "Impianti hidroelektrik")mbi bazen e nje koncesioni me afat 30 vjecar te impiantit hidroelektrik dhe qe rregullohet me ane te ligjit shqipetar te 26 korrikut 1995 nr.7973 me ndryshimet e metejshme.
- b) Shitjen ne territorin shqipetar si dhe eksportimin e energjise elektrike te prodhuar nga impianti hidroelektrik si dhe ne emer te paleve te treta
- c) Realizimi i aktivitetit kerkimor ,konsulences dhe mbeshtetjes ne te gjitha fushat te lidhura me qellimin e aktivitetit dhe cdo aktivitet tjetër qe do te lejonte perdorimin dhe vleresimin e strukturave,resurseve dhe aftesive qe jane te perfshira dhe ne ndonje menyre te lidhura apo te rendesishme per impiantin hidro elektrik dhe per projektin e zhvillimit te tij; dhe
- d) Realizimi e atij aktiviteti te lidhur,instrumental apo te ngjashem a komplementar dhe ne ndonje menyre te dobishem per permbushjen e sherbimeve dhe /ose te aktiviteve te siperpermendura.

Shoqeria do te jete e afte permbushe qellimin e aktivitetit te saj primar dhe aktivitetit te saj sekondar brenda kufijve te parashikuar nga ligji i aplikueshem,me perjashtim te gjitha aktiviteve te rezervuara te parashikuara me ane te dispozitave te vecanta, te lidhura kryesisht me sektoret e sherbimeve profesionale financiare dhe bankare si dhe:

- I. Te permbushe te gjitha transaksionet tregtare,industriale,te lidhura me pasurite e paluajtshme,kembimit valutor dhe finciar ,te nevojshem qofte edhe vetem per qellimin e aktivitetit.
- II. Te akordoje mbeshtetje dhe garanci ,te vendose hipoteke mbi asetet e paluajtshme te shoqerise si dhe cdo lloj garancie tjetër qofte edhe garanci reale ne lidhje me detyrimet e saj apo te paleve te treta ;dhe
- III. Te perfitojne ne menyre direkte apo indirekte ,interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqipetare apo te huaja qe kane nje qellim te njejte biznesi ,te lidhur me qellimin e vete shoqerise ,apo te shoqerive te tjera dhe ne funksion te nje investimi permanent pervec aktiviteve qe lidhen me kryerjen e kembimit valuator dhe qe nuk kryhen kundrejt publikut.

Kapitali Shoqerise Neni 5

Kapitali fillestar i shoqerise është 500,000 leke i perbere nga 500 pjese, me vlere nominale 1,000 leke secila.

Kontributi i ortakeve ne kapitalin themeltar eshte si me poshte:

- Shoqeria BEG S.p.A., zoteron 70% te kapitalit fillestar te shoqerise me vlere 350,000 (treqind e pesedhjete mije) Leke.
- Shoqeria "Energji "shpk, zoteron 20% te kapitalit fillestar te shoqerise me vlere 100,000 (njqind mije)Leke.
- Shoqeria CO.LA.RI , zoteron 10% te kapitalit fillestar te shoqerise me vlere 50,000 (pesedhjete mije) Leke.

Zmadhimi i kapitalit te shoqerise Neni 6

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet ne perputhje me legjislacionin shqipetar.

Vendimi I Asamblese se Ortakeve Neni 7

Vendimi I asamblese se ortakeve duhet te merret nepermjet mbledhjes se asamblese se ortakeve apo nepermjet konsultimeve me shkrim te ortakeve.

Asambleja e Ortakeve Neni 8

Mbledhja e ortakeve thirret nga organi administrativ me bazen e nje kerkese se ortakeve te shoqerise qe perfaqesojne te pakten 10% te kapitalit te shoqerise.

Mbledhja e Asamblese e ortakeve do te thirret nepermjet nje njoftimi me ane te cdo lloj mjeti komunikimi qe siguron proven e marrjes ne dijeni dhe I dergohet seicilit prej ortakeve qe kane emrin e regjistruar ne librat e shoqerise dhe ne adresen qe rezulton nga libri I procesverbaleve te pakten 15 dite perpara se te mbahet mbledhja.

Njoftimi duhet te perfshije: vendin,daten,si dhe oren duke perfshire edhe ceshtjet e rendit te dites.

Asambleja e ortakeve mund te mbahet edhe jashte selise zyrtare te shoqerise ,ne Itali ose jashte shtetit ,me kusht qe vendi te jete ne Europe.

Edhe nese asambleja e ortakeve nuk eshte thirrur ne perputhje me proceduren e mesiperme ,ajo do te jete e vlefshme nese i gjithë kapital perfaqesohet nepermjet

ortakrve te perfaqesuar me prokura te vlefshme dhe te gjithë ortaket deklarojne qe jane informuar rreth ceshtjeve te dites dhe anjeri nga ata nuk i ka kundërshtuar ato.

Secili nga ortaket e shoqerise ka te drejte te perfshije ne rendin e dites nje ceshtje per te cilen ai deshiron te diskutoje. Per kete qellim ai duhet ti informoje ortaket e tjere te pakten 3 dite me pare.

ASAMBLEJA E ZAKONSHME DHE E JASHTEZAKONSHME

Neni 9

Asambleja e Ortakeve mund te jete e Zakonshme apo e Jashtezakonshme

1)Asambleja e zakonshme e ortakeve .Ajo mund te thirret nga organi administrativ ,te pakten njehere ne vit ,brenda 4 muajve duke filluar nga dita e fundit te vitit financiar.(1 janar – 31 dhjetor).Ne kushte te jashtezakonshme asambleja e jashtezakonshme e ortakeve mund te thirret brenda 6 muajve duke filluar nga fundi I vitit financiar.

1.1 Asambleja e zakonshme mund te marre vendime të vlefshme si vijon:

- a) Në mbledhjen e pare ,në prezencen e të gjithë ortakeve që perfaqesojne me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit të shoqerise, te pranishem personalisht apo të perfaqesuar nga persona të trete me ane të prokurave te posacme.
- b) Në rast se nuk do te krijohet kuorumi I nevojshem ,në mbledhjen e dyte ,të gjitha vendimet do të merren me ane të shumices se votive të ortakeve të pmaishem pavarisist nga perqindja që ata zoterojne në kapitalin e shoqerise..

1.2) Asambleja e Zakonshme e Ortakeve vendos ne lidhje me cdo ceshtje te lidhur me administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise ,pervec ceshtjeve per te cilat vendos asambleja e jahstezakonshme e ortakeve apo ato atyre ceshtjeve qe I jane njohur organit administrative.

2)Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve thirret nga organi administrativ ne rast se eshte e nevojshme apo mbi bazen e kerkeses se 10% te ortakeve qe perfaqesojne 10% te shoqerise.

2.1) Ne asamblene e jashtezakonshme te ortakeve ,vendimet do te jene te vlefshme kur ato merren me shumicen e ortakeve qe perfaqesojne $\frac{3}{4}$ e kapitalit te shoqerise

2.2) Asambleja e Jashtezakonshme ka kompetencat e e meposhtme:

- Ka te drejte te beje ndryshime ne statutin shoqerise.
- Ben transferimin e kuotave te te tretet.
- Miratimi I cdo vendimi te marre ne kuader te kompetencave te Asamblese se jashtezakonshme te ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi.



Vendimet e marra nepermjet konsultimeve me shkrim

Neni 10

Vendimet e marra nepermjet konsultimeve me shkrim, konsistojne ne propozim- vendim qe u dergohet ortakeve neper selite e tyre nepermjet cdo lloj mjeti komunikimi qe eshte I pershtatshem per te vertetuar marrjen ne dijeni te ortakeve .

Propozimi duhet te specifikoje permbajtjen e vendimit qe do te merret ,arsyet si dhe gjithshka qe eshte e nevojshme per te informuar ortaket rreth ceshtjeve te rendit te dites.

Cdo ortak duhet ti njoftoje voten e tij shoqerise ,ne seline zyrtare te saj brenda 15 diteve nga marrja e vendimit te propozuar me ane te cdo lloj mjeti komunikimi qe siguron vertetimin per marrjen dijeni te shoqerise .

Vota e cdo ortaku duhet te bashkangjitet ne fund te faqes se vendimit te propozuar dhe duhet te shprehe aprovimin ,refuzimin,apo abstenimin.Nese nje ortak nuk arrin ta dergoje voten e tij brenda afatit te mesiperme,ai do te konsiderohet sikur ka dhene pelqimin e tij.

Organi administrativ do te kete kompencen e mbledhjes se votave te ortakeve dhe menjehere do te njoftoje rezultatet e vendimeve te ortakeve.

Vendimi I ortakeve I marre nepermjet modalitetit te parashikuar ne kete nen do te jete I vlefshem dhe i detyrueshem per shoqerine vetem ne rast se do te merret me shumicen e votave te ortakeve qe perfaqesojne perqindjen e kapitalit te parashikuar nga neni nr 9 me siper.

Te drejtat e ortakeve

Neni 11

Te gjithe ortaket ,emrat e te cileve jane perfshire ne librin e shoqerise kane te drejte te marrin pjese ne mbledhje.Cdo ortak qe ka te drejte te marre pjese ne mbledhje,mund te perfaqesohet me ane te nje perfaqesuesi te pajisur me prokure I cili nuk duhet te jete njeri nga ortaket .Prokurat nuk mund te leshohen ne emer te administratoreve ,edhe kur ata jane ortake te shoqerise .

Cdo ortak I shoqerise ka te drejte te ushtroje te drejten e tij te votes ne asamblene e ortakeve ne perputhje me pjesen qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise.

Neqoftese eshte e nevojshme ,ortaket mund te vendosin te therrasin ne mbledhjen e asamblese edhe eksperte,audite etj.

ADMINISTRIMI

NENI 12

Shoqeria do te drejtohet ne menyre alternative ,nga nje administrator apo nga nje keshill administrativ qe perbehet nga 3-5 administratore qe do te emerohen sipas vendimit te ortakeve .

Me organ administrative do te kuptohet nje administrator I vetem ose keshilli admnistrativ sipas rastit.

Administratoret mund të jene në të njëjtën kohë edhe ortake.

Administratori I vetëm ose anëtarët e keshillit administrativ, sipas rastit, emerohen nga asambleja e ortakeve për një afat prej 3 vitesh .shkarkimi I administratoreve do të kryhet në përputhje me dispozitat e ligjit.

Administratoret mund të rizgjidhen.

Në rastin e emerimit të një keshilli administrativ, nëse për ndonjë arsye , shumica e anëtarëve të keshillit të apo administratori ekzekutiv, sipas rastit , shkarkohen nga detyra e tyre , të gjithë anëtarët e tjere , do të shkarkohen automatikisht dhe një keshill administrativ i ri do të emerohet nga mbledhja e asamblese së ortakeve.

Perfundimi I mandatit të administratoreve që vjen si shkak I mbarimit të afatit të këtij mandati , do të hyjë në fuqi në datën e emerimit të administratorit të ri.

Administratoreve nuk u lejohet të kontrahojnë në çfarëdo lloji forme, të marrin hua tek shoqëria, të japin pelqimin në emer të saj, për paradhënie si dhe të behen dorezanes apo të garantojnë në emer të saj angazhimet ndaj të tjerëve.

Administratori I vetëm apo keshilli administrativ, sipas rastit kanë si kompetence administrimin e zakonshëm përveç kompetencave që I njihen asamblese së ortakeve.

Organi administrativ është i detyruar të mbajë regjistrat e magazinimit të cilat vihen në dispozicion të Zyres Doganore për të mundësuar kryerjen e kontrolleve prej saj.

Organi administrativ është i detyruar të mbajë inventare të rregullta një herë në muaj. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore, hartohen nga Administratori.

Keshilli Administrativ

Neni 13

Në rast të emerimit të keshillit administrativ, vetë keshilli administrativ do të emerohet midis anëtarëve të tij një kryetar dhe një administrator ekzekutiv , I cili do të zëvendësojë kryetarin në rast të ndonjë mungese apo pamundësie të këtij të fundit dhe një sekretarë.

Keshilli administrativ do të marrë vendimet nëpërmjet mbledhjes :

Kryetari do të thërresë keshillin administrativ , do të përcaktojë rendin e ditës , do të bëjë të mundur njoftimin dhe informimin e ortakeve në lidhje me çështjet që do të diskutohen.

Mbledhja e keshillit do të thirret me anë të një njoftimi të dërguar të gjithë administratoreve me anë të çdo mjeti komunikimi që bën të mundur vertetimin e marrjes dijeni nga ana e çdo administratori, të pakten 3 ditë përpara mbledhjes dhe , në rast të një mbledhje urgjente , të pakten një ditë përpara kesaj mbledhjeje.

Njoftimi duhet të përmbajë datën , vendin dhe orën e mbledhjes si dhe rendin e ditës.

Në rast se njoftimi është dërguar me faks ose me email me ndonjë mënyrë tjetër komunikimi të përshtatshme , njoftimet do të dërgohen në numrin e faksit , në adresën e emailit dhe/ ose në adresën e përcaktuar e cila është bërë e ditur nga vetë administratoret apo ekspertët në rast se ka të tilla , dhe që rezultojnë nga libri I administratoreve.

Keshilli do te mblidhet mbidhet ne seline zyrtare te shoqerise apo diku tjeter ,me kusht qe te jete ne Shqiperi.

Mbledhjet e keshillit dhe vendimet do te jene te vlefshme ,e dhe ne rast te mungeses se nje njoftimit ,kur te gjithë administratorët ne fuqi dhe ekspertët ,ne rast se thirren,jane te pranishem.

Mbledhjet e keshillit administrativ mund te mbahen ne menyre te vlefshme me ane te konferencës telefonike apo video konference me kusht qe te plotesohen situatat e meposhteme:

a. Ne rast se Kryesuesi i mbledhjes , I cili mund te jete ose kryetari i keshillit administrative ose ndonje prej anetareve te keshillit te emeruar nga te pranishmit ,dhe sekretari (nese ka te tille) jane te pranishem ne te njejtin vend dhe hartojne dhe nenshkruajne procesverbalin e mbledhjes.Keshilli do te konsiderohet se eshte mbajtur ne ate vend.

b.Kryetari I mbledhjes ka te drejte te kerkoje rreth identitetin e personave te pranishem ne mbledhje ,te jete moderator I mbledhjes ,te percaktoje dhe te deklaroje rezultatet e procedures se votimit.

c. Personi qe perpipon procesverbalin ka te drejte te regjistroje ceshtjet e mbledhjes te cilat do te pershkruben ne keto procesverbale.

d. Te pranishmit te mbledhje kane te drejte te marrin pjese ne diskutim dhe te votoje respektivisht te gjitha ceshtjet e rendit te dites,si dhe te shqyrtojne ,marrin apo transmetojne dokumentet.

Vendimet e keshillit administrativ do te merren me ane te votave te shumices se administratorëve ne detyre.

Vendimet e marra gjate mbledhjes do te regjistrohen ne procesverbal ,si dhe do te nenshkruhen nga kryetari dhe sekretarja (nese ka te tille)dhe do te regjistrohen ne librin e administratorëve.

Aktualisht shoqeria administrohet nga nje keshill administrative I cili perbehet nga tre administratore si me poshte:

1. Z.Francesco Becchetti ,shtetas italian,lindur ne Rome- Itali me 31.08.1966 ,banues ne Rome -Itali, via indonesia 70, mbajtes i pasaportes me nr. B 841745 kryetar i keshillit administrativ.
2. znj. Liliana Condomitti ,shtetase italiane ,lindur ne Rome -Itali me date 2.09.1941,banuese ne Rome -Itali ,via indonesia 70 ,mbajtese e pasaportes me nr. AA0405895.
3. Z.Andi Kondi ,shtetas shqipetar ,lindur ne Tirane ,shqiperi me 27.05.1971,banues ne Tirane ,rr."Mihal Grameno"pallati 94,shk.2 ap 25.

Kompetencat e Organit Administrativ

Neni 14

Organi administrative mund te kryeje te gjitha veprimet dhe transaksionet ne lidhje me drejtimin e zakonshem te shoqerise,pervec atyre veprimtarive te cilat ligji,eksluzivisht ia njej ortakeve ,dhe pervec kompetencave qe u njihen asamblese se ortakeve.

Ne rast te emerimit te nje keshilli administrative ,ky I fundit mund tia delegoje te gjitha ose nje pjese te kompetencave te tij ,administratorit ekzekutiv

Perfaqesimi

Neni 15

Administratori I vetem ka te drejte te perfaqesoje shoqerine .

Ne rast se eshte emeruar nje keshill administrative,kryetari dhe administratori ekzekutiv ,kane te drejten te perfaqesojen shoqerine .

Menaxheret,perfaqesueit dhe avokatet do te kene gjithashtu te drejten te perfaqesojne shoqerine Brenda kufijve te kompetencave qe iu eshte dhene atyre ne baze te kompetencave te dhena atyre.

EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Neni 16

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise, i besohet nje ekspertit ose revizorit kontabel nga asambleja e ortakeve. Ne cdo rast nje ekspert apo revizor do te emerohet posacerisht ne rastet e kerkuara nga ligji.Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Asambleja zakonshme e Ortakeve cakton dhe shperblimin perkates.

BILANCI DHE SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 17

Veprimtaria ekonomike e shoqerise fillon me 1 janar dhe te mbyllet ne dt. 31 Dhjetor te cdo viti. Organi administrativ merr masa per hartimin e bilancit dhe rezultatin ekonomik fitim - humbje dhe inventarin. Pasi vecohen fondet si me siper dhe paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten ndahen midis ortakeve

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

Neni 18

Ne rast se shoqeria do te shperndahet per cdo lloj arsye Asambleja e Ortakeve percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'regjistrimin e saj nga Regjistri Tregtar.

Ne rast se kapitali i shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, pronaret vendosin brenda 4 muajve per mundesine e prishjes se shoqerise.

LIBRAT E SHOQERISE

Neni 19

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

- 1) Libri i Ortakeve
- 2) Libri i Mbledhjeve
- 3) Libri i vendimeve te administratorit
- 4) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel.

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME
Neni 20


Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", Statutit dhe rregullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

The Statute of company is signed by the partners company, today in Tirana, on 2007.

ORTAKET E SHOQERISE "KALIVAC GREEN ENERGY" SH.P.K.

Shoqeria BEG S.p.A.

Z. Santa Diotallevi



Shoqeria CO.LA.RI srl

Z. Aldo Ceccobelli



Shoqeria ENERGJI Sh.p.k.

Z. Andi Kondi

